

# Modul 4-5

Llojet e të dhënave - primare dhe dytësore  
Analiza e të dhënave

Dr Eralda Zhilla

# 1. Të dhënat primare

- ▶ Të dhëna që vijnë drejtpërdrejtë nga terreni
- ▶ Janë më të besueshme, autentike dhe objektive
- ▶ Nuk janë publikuar më parë
- ▶ Nuk janë modifikuar apo ndryshuar
- ▶ Në një studim ne marrim info kryesor nga të dhënat primare, pasi të dhënat dytësore mund të modifikohen nga njerëzit.
- ▶ Cilat metoda shërbejnë për të mbledhur të dhëna primare:

eksperimenti

fokus grup

pyetësi

studimi rastit

intervista

ditari

vëzhgimi

analizat statistikore

# a. Pyetësori

- ▶ Përmban një seri pyetjesh që përputhen me qëllimin e studimit
- ▶ Pyetjet grupohen në varësi të analizave që duam të bëjmë
- ▶ Mund të përmbajnë pyetje që masin preferenca, sjellje, tipare, qëndrime apo fakte.
- ▶ Përdorin pyetje me fund të mbyllur ose pyetje me fund të hapur.
- ▶ Ka disa mënyra administrimi:
  - ▶ Ballë për ballë kur një intervistues lexon pyetjet
  - ▶ Me vetëadministrim
  - ▶ Me telefon
  - ▶ Me kompjuter

## b. Intervista

### *Avantazhet*

- ▶ Lejon respondentët të shprehin lirshëm atë që mendojnë dhe gjykojnë.
- ▶ Informacioni që merret priret të jetë i besueshëm dhe i vërtetë.
- ▶ Lejon intervistuesin të kërkojë të dhëna të tjera që i interesojnë intervistës.
- ▶ Intervistuesi është fleksibël në punën e tij.

## *Disavantazhet*

- ▶ Në disa raste bëhet shumë intruzive. Jo gjithmonë respondentët janë të gatshëm të japin informacionin e tyre personal.
- ▶ Ndikon gjëndjen emocionale dhe humorin e palëve.
- ▶ Trajnimi i intervistuesve ka shumë kosto dhe kërkon kohë.
- ▶ Analiza dhe interpretimi i të dhënave mbetet një proces i vështirë, që ka kosto dhe kërkon nivel të lartë profesionalizmi.
- ▶ Ka nota të larta subjektivizmi në gjykimin dhe analizën e rezultateve.

## *Nisja e intervistës dhe perceptimet*

- ▶ Njëra nga palët e përfshira bëhet nismëtarja e intervistës.
- ▶ Nuk ka rëndësi se kush e nis procesin, rëndësi ka të respektohen kushtet dhe qëllimi i intervistës.
- ▶ Rolet të jenë të përcaktuara qartë.
- ▶ Në disa raste, është vetë situata që shërben si nismëtare dhe pozicionon njërin apo tjetrën palë për të filluar procesin
- ▶ Cdo individ kur bëhet pjesë e procesit të intervistimit ka krijuar pritshmëritë e tij dhe i percepton variablat përbërës nga këndvështrimi i tij.
- ▶ Kjo ndikohet gjithashtu edhe nga pozicioni i secilës palë në intervistë.
- ▶ Secila palë ka interes në realizimin dhe përmbushjen e qëllimit final të intervistimit, por qëllimet dhe dëshirat personale janë krejt të ndryshme.
- ▶ Psh: Një profesor ndihet komod nëse ulet në katedrën e tij dhe pyet studentin, ndërkohë që ky i fundit përjeton emocione të forta kur ndodhet përpara tavolinës së profesorit.

## *Koha dhe vendi kryerjes së intervistës*

- ▶ Kur kryejmë intervistën duhet të marrim parasysh shumë variabla. Në rradhë të parë duhet studiuar situata që paraprin, koha nëse është apo jo e përshtatshme, dita, perioda (nëse është fundjav, kohë festash etj).
- ▶ Edhe pse shpeshherë është e pamundur respektimi i të gjithë faktorëve, palët e përfshira në intervistim duhet të përpiqen të bëjnë më të mirën
- ▶ A është vendi gjithmonë i përshtatshëm për intervistën që kryejmë?
- ▶ A zgjedhim ne më të mirin e mundshëm?
- ▶ Cfarë kriteresh përdorim për të zgjedhur vendin e duhur?
- ▶ E rëndësishme është zgjedhja e një vendi që ndihmon komunikimin ndërmjet palëve, qoftë kjo në një vend të njohur apo të panjohur për respondentët.
- ▶ Do e ndihmonte komunikimin nëse ju pyesni palën tjetër për vendin në të cilën ajo ndihet më rehat dhe vazhdoni më pas procesin e intervistimit.

## c. Fokus grupi

- ▶ Diskutim për një çështje të caktuar 60 deri 90 min.
- ▶ Mbledh bashkë 6 - 10 persona që janë homogjen në atë që do diskutojnë.
- ▶ Një moderator drejton procesin për të mbledhur opinione, qëndrime dhe shkaqe për sjelljen e tyre.
- ▶ Kryesisht drejtuesi drejton procesin me një intervistë gjysëm të strukturuar.
- ▶ Seanca shoqërohet nga një moderator dhe një vëzhgues që mban shënimet.
- ▶ Zhvillimi i një focus grupi kalon në 8 faza:

Percaktojmë aktivitetet që duhet të zhvillojmë -  
caktojmë llojin e grupit (nr, sa do bëjmë, si do i mbledhim) -  
zgjedhim moderatorin dhe vëzhguesin -  
strukturojmë çështjet që do trajtohen -  
trajnojmë drejtuesit e grupit dhe zhvillojmë një fazë pilot -  
caktojmë vendin dhe orën kur do u zhvillojmë -  
nisim punën me grupin, diskutojmë, mbledhim info -  
analizojmë dhe interpretojmë rezultatet.



## d. Vëzhgimi

- ▶ Vëzhgimi është një mënyrë sistematike e mbledhjes së të dhënave.
- ▶ Ne njohim disa lloje të vëzhgimit:

Rastësor

Natyror

Direkt dhe indirekt

I strukturuar dhe pastrukturuar.

Me pjesëmarrje / pa pjesëmarrje.

Disa mënyra si mblidhen të dhënat:

Shënojmë cdo gjë që shohim dhe dëgjojmë

Regjistrojmë të dhëna cilësore

Regjistrojmë të dhëna sasiore

Analizojmë rezultatet.

## e. Studimi rastit

- ▶ Studimi i rastit është një njohje e thellë e një personi, eventit, grupi apo komuniteti.
- ▶ Shpesh vjen në ndihmë të informacionit të mbledhur me metoda të tjera.
- ▶ Ka një skedule pyetjesh dhe analize.
- ▶ Kërkon trajnim të intervistuesit.

## 2. Të dhënat dytësore

- ▶ Të dhënat dytësore vijnë si rezultat i materialit të mbledhur me metoda primare.
- ▶ Marrin më pak kohë për tu mbledhur dhe mblidhet shumë info.
- ▶ Të dhënat që grumbullohen janë cilësore ose sasiore në varësi të metodës primare ku mbështetemi.
- ▶ Këto të dhëna mund të gjenerohen nga këto burime:
  - ▶ Libra
  - ▶ Revista
  - ▶ Gazeta
  - ▶ Artikuj shkencor
  - ▶ Raporte
  - ▶ Ditare
  - ▶ Adresa online
  - ▶ Statistika

# Analiza e të dhënave

- ▶ E gjithë puna e bërë duke filluar që nga procesi i dizenjimit të pyetësorit apo intervistës, drejtimit të pyetjeve, paratestimit e të tjera si këto, finalizohet duke mbledhur të dhënat dhe analizuar ato në përputhje me kërkesat e parashtruara më pare.
- ▶ Kjo është pjesa më interesante e punës suaj, pasi merrni frutet e asaj cfarë keni bërë dhe imagjinoni raportin përmbledhës.
- ▶ Cfarë kuptojmë me: analiza të dhënash?
- ▶ Gjatë kësaj faze ne merremi me shqyrtimin e marrëdhënieve të mundshme që krijohen, diferencat, gjetjen e shkaqeve për gjërat që ndodhin.

# Analiza e të dhënave përfshin disa nivele:

**Në nivelin e parë të analizës**, ju përqëndroheni në përshkrimin e të dhënave, psh sa përqind e respondentëve u përgjigjën po dhe sa përqind jo në pyetjen “e keni përfunduar gjimnazin?” Kjo e dhënë mat më tepër frekuencën e përgjigjeve. Nuk ka mendim analitik. Të dhënat në këtë rast mund të mblidhen edhe me kompjuter e mund të kodohen me numra.

**Niveli i dytë i analizës** së të dhënave, nis kur ka përfunduar faza përshkruese. Në këtë fazë matet pesha që zë cdo e dhënë, duke e krahasuar me të gjithën. Shihen dhe krahasohen lidhjet mes pyetjeve, duke iu përmbajtur hipotezave të studimit. Psh a ekziston ndonjë lidhje ndërmjet gjinisë dhe faktin nëse respondentit e ka përfunduar apo jo kolegjin? Pra analizohen lidhjet ndërmjet variablave

**Niveli i tretë i analizës** është më kompleksi. Përmbledhen shumë variabla në të njëjtën kohë dhe i jepet përgjigje shumë pyetjeve njëherësh. Identifikohen faktorët dhe analizohet sesi ato ndikojnë në secilin nga variablat e studimit. Komplexiteti i analizës së të dhënave varet shumë nga objektivat që janë vendosur në fillim të studimit. Analizat shkak - pasojë janë më komplekse se ato që mbeten në nivele përshkruese dhe normative.

# Kodimi dhe analiza e të dhënave

- ▶ Pasi është mbledhur informacioni i nevojshëm për studimin, ai duhet koduar, hedhur në tabelë dhe analizuar sipas variablave të përcaktuar më parë. Shënojmë një kod për çdo pyetje që drejtojmë dhe përgjigjet i klasifikojmë duke mbajtur numrin e pyetjes dhe duke shtuar numra të tjera në varësi të sasisë së përgjigjes. Psh: Pyetja 20 është: “Ju thatë që ju dilni e pini diçka në baret afër kampusit të enjten, të premten dhe të shtunën në mbrëmje. Pse veproni kështu?”
- ▶ 20 - 1 Të gjithë miqtë e mi bëjnë të njëjtën gjë
- ▶ 20 - 2 Ky qytet nuk të ofron asgjë tjetër
- ▶ 20 - 3 Më pëlqen, kënaqem.
- ▶ 20 - 4 Harroj presionin e jetës dhe provimeve kur jam atje
- ▶ 20 - 5 Mund të takosh persona interesantë
- ▶ 20 - 6 Më pëlqen shumë të pi.

# Analiza cilësore....

- ▶ Ndërkohë që për pyetjet me fund të hapur, procesi i kodimit është më i vështirë.
- ▶ Nuk ka alternativa si në rastin e mësipërm ndaj ndiqet një tjetër mënyrë për të koduar dhe analizuar të dhënat.
- ▶ Shihen përgjigjet që kanë dhënë respondentët për secilën pyetje dhe nxirren fjalët më frekvente ose fjalët kyç.
- ▶ Edhe pse respondentit mund të japë përgjigje me shumë fjalë, ato grupohen sipas disa kategorive dhe shihet frekuenca e secilës kategori.
- ▶ Kjo ndihmon në analizën e përgjithshme të të gjitha pyetjeve të hapura.

## Gjatë analizës duhet t'i drejtojmë vetes një sërë pyetjesh:

- ▶ • Cfarë konkluzionesh mund të nxjerrim dhe sa të sigurt jemi për to?
- ▶ • A mund të bëjmë përgjithësime për popullata të caktuara?
- ▶ • Pse janë dhënë përgjigje të ndryshme për të njëjtat pyetje?
- ▶ • Si duhet të veprojmë kur respondentit nuk është përgjigjur për pyetje të caktuara?
- ▶ • A janë realizuar qëllimi dhe objektivat e studimit?
- ▶ • Si mund t'i prezantojmë rezultatet tona?